



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

PROGRAMI I STUDIMIT



KËRKIMI SHKENCOR




SHERBIMI PER TE TRETE



## PROGRAMI

# PERMIRESIMI I CILESISE NE AKTIVITETET E UPT

(2009 - 2011)



DOKUMENTI 1/5

Tirane, 2009



**2009 - 2011**  
DREJT STANDARDEVE  
EUROPIANE TE CILESISE



## **PERMIRESIMI I CILESISE NE AKTIVITETET E UPT**

**Programi tre vjeçar 2009 - 2011**

**PARAQITJA E BAZES SE PROGRAMIT**

**DRAFT**

---

---

PERMBAJTJA	Faqja
<b>Kontribuesit kryesore ne ndertimin dhe implementimin e Programit .....</b>	<b>2</b>
<b>Pjesa 1-re: Te pergjithshme .....</b>	<b>3</b>
Backgraundi i Programit .....	3
Qellimet e Programit .....	5
Objektivat e Programit .....	5
Parimet kryesore te formulimit dhe aplikimit te Programit .....	6
Skema logjike e Programit .....	6
Kohezgjatja e Programit .....	7
<b>Pjesa 2-te: Procesi sensibilizues dhe projektet e Programit .....</b>	<b>8</b>
Procesi i fushates sensibilizuese-informuese.....	8
Projekti PR 1: Ndertimi i Sistemit te standardeve institucionale te UPT .....	8
Projekti PR 2: Ngritja e Qendres se Sigurimit te Cilesise. Vleresimi i brendshem i cilesise ne UPT sipas standardeve institucionale te tij .....	10
Projekti PR 3: Aritja e niveleve te planifikuara te cilesise ne UPT, nepermjet rritjes intensive dhe ekatensive te nivelit te standardeve institucionale te miratuara .....	11
Dokumentacioni i Programit .....	12
<b>Pjesa 3-te: Nevojat dhe burimet per realizimin e Programit .....</b>	<b>14</b>
Nevojat financiare .....	14
Burimet .....	14
<b>Pjesa 4-t: Dokumente permbledhese: .....</b>	<b>15</b>
Plani kalendar i realizimit te dokumentacionit dhe te implementimit te Procesit PSI dhe te projekteve te Programit .....	16
List-pagesa e kontribuesve ne realizimin e Paraqitjes se Bazes se Programit ...	17
<b>Shtojca: Fjalorthi .....</b>	<b>18</b>

## Kontribuesit kryesore ne ndertimin dhe implementimin e Programit

Ideatoret e Programit: Akademik Jorgaq KAÇANI, Prof. Dr. Perparim DEÇOLLI

Konceptuesi dhe formuluesi i dokumentacionit (pese dokumentet) te Programit: Prof. Dr. Perparim DEÇOLLI

Bashkepunuesit ne ndertimin e Programit: Akademik Jorgaq KAÇANI ..., Rektor i UPT  
Prof. As. Akli Fundo ....., Zv. Rektor i UPT  
Prof. Dr. Rozeta MITRUSHI , Zv. Rektore e UPT  
Ekon. Shpetim ZAIMI ....., Kancelar i UPT

Prof. As. Andrea MALIQARI, Dekan i FIN  
Dr. Elfrida ALLIU ....., Zv. Dekane e FIN  
As.Ped. Alket KUMARAKU., perfaqesues i FIN per cilesine

Prof. Dr. Andonaq LONDO .., Dekan i FIM  
Dr. Genti GUXHO....., Zv. Dekan i FIM  
As. Ped. Ilo BODL....., perfaqesues i FIM per cilesine

Akademik Gudar BEQIRAJ ....., Dekan i FTI  
Dr. Elida KAJO ....., Zv. Dekane e FTI  
Dr. Elma ZANAJ ....., perfaqesues i FTI per cilesine

Prof. Dr. Perparim HOXHA .., Dekan i FGJM  
Prof. As. Skender LIPO ....., Zv. Dekan i FGJM  
Dr. Nevton KODHELI .., perfaqesues i FGJM per cilesine

Prof. Dr. Pirro CIPO ....., Dekan i FIE  
Dr. Orion ZAVALANI ....., Zv. Dekan i FIE  
Msc.Ing.. Nike SHAMKU ....., perfaqesues i FIE per cilesine

Prof. Dr. Tatjana MULAJ....., Dekane e FFP  
Prof. As. Ligor NIKOLLA ....., Zv. Dekan i FFP  
Msc. Dhurata KUQI ....., perfaqesues i FFP per cilesine

Prof. Dr. Marenglen GJONAJ, Drejtor i INEUM  
Dr. Bashkim LUSHAJ ....., Zv. Drejtor i INEUM  
Msc. Bledar MURTAJ ....., perfaqesues i INEUM per cilesine

Prof. Dr. Ismail HOXHA ....., Drejtor i INGJSH  
Dr. Idriz JATA ....., Zv. Drejtor i INGJSH  
Msc. Irena YMETI ....., perfaqesuese e INGJSH per cilesine

Besnik BALA ....., perfaqesues i Keshillit Studentor (FIN)  
Florenc VEIZI ....., perfaqesues i Keshillit Studentor (FIM)  
Ardit ÇELA ....., perfaqesues i Keshillit Studentor (FTI)  
Erald SILO ....., perfaqesues i Keshillit Studentor (FGJM)  
Denis MATI ....., perfaqesues i Keshillit Studentor (FIE)  
Erla NDREAJ ....., perfaqesues i Keshillit Studentor (FFP)

Bashkepunuesit ne zbatimin e Programit: Drejtuesit e te gjithe niveleve hierarkike te struktures organizative te UPT (nga Rektori e deri tek pergjegjesit e departamenteve) si dhe te gjithe anetaret e stafave akademike, ndihmese dhe studentet e UPT.

Pergjegjesi per zbatimin e Programit: Dr. Genti GUXHO, Drejtor (Pergjegjes) i Qendres se Sigurimit te Brendshem te Cilesise ne UPT

Konsulentit ne zbatimin e Programit : Prof. Dr. Perparim DEÇOLLI

## **PJESA 1-RE: TE PERGJITHSHME**

### **BACKGRAUNDI I PROGRAMIT**

Universiteti Politeknik i Tiranës i ka fillimet e tij që nga viti 1951, me ngritjen e Institutit të Lartë Politeknik në Tiranë. Instituti përmbante disa degë kryesore inxhinierike si Degen e Inxhinierisë Mekanike, Degen e Inxhinierisë Elektrike, Degen e Inxhinierisë së Ndertimit.

Në fillim, stafi akademik i Institutit të Lartë Politeknik ka patur në përberje të tij pedagogë ruse dhe asistente shqiptare, të diplomuar në fakultetet inxhinierike, kryesisht të vendeve të Europës Lindore. Gradualisht, me rritjen e nivelit të kualifikimit dhe të specializimit, u bë e mundur zëvendësimi i plotë i pedagogëve të huaj me pedagogët vendas.

Në vitin 1957 u formua Universiteti Shtetëror i Tiranës i përbërë nga një numër fakultetesh, të cilët i gruponin pedagogët dhe laborantët sipas katedrave. Në përberjen e Fakultetit të Inxhinierisë u vendosën Dega Mekanike, Dega Elektrike, Dega e Ndertimit dhe dega e Gjeologji-Minierave, në të cilat diplomoheshin inxhinierë të përgjithshëm sipas katër fusha përkatëse inxhinierike..

Viti 1971 ishte viti i perfundimit të ristrukturimit të parë të programeve të studimit në Fakultetin e Inxhinierisë. Në përputhje me kërkesat e industrisë shqiptare të asaj kohe, e cila po merrte një zhvillim relativisht të madh, në të katër programet e studimit u krijuan profile, në një numër të përshkaktshëm të kufizuar. Në këtë periudhë filluan kualifikimet e para të stafit akademik jashtë shtetit, nëpërmjet specializimeve afatshkurtesh dhe afatgjatë, gjë që dha ndikim të dukshëm në cilësinë mesimdhënëse dhe kërkimin shkencor.

Krijimi i Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT) në vitin 1991 bëri të mundur krijimin e katër fakulteteve : të Inxhinierisë Mekanike (FIM), Inxhinierisë Elektrike (FIE), Inxhinierisë së Ndertimit (FIN), Inxhinierisë Gjeologji-Miniera (FGJM), mbi bazën e katër degëve ekzistuese. Në këtë kuadër u ndertuan programe të rinj studimi dhe u rrit numri i drejtimeve të tyre.

Në vitin 1994 struktura organizative e fakulteteve të UPT ndryshoi mbi bazën e departamentizimit, të detajuar deri në seksione.

Periudha e viteve 90-të dhe e gjysmës së parë të viteve 2000 ka qenë periudha e specializimit të gjere të stafëve akademikë dhe ndihmës të fakulteteve të UPT në vende të ndryshme të Europës Perëndimore, si dhe e mobiliteteve të studenteve të disa programeve të studimit.

Gjate kësaj periudhe UPT i ka kushtuar vëmendje të madhe lidhjes, komunikimit dhe bashkëpunimit si me partneret brenda vendit ashtu dhe me partneret homologe jashtë vendit. Ka vite që ka filluar një bashkëpunim i frutshëm i UPT, veçanërisht në fushën e mesimdhënies, me universitetet e tilla si Politekniku i Barit (Itali), Politekniku i Torinos (Itali), Instituti Politeknik i Athinës, Universiteti i Sigenit (Gjermani), Bergakademie Freiberg (Gjermani), Universiteti i Metz (France), Instituti i Lartë i Materialeve dhe i Konstruksioneve Mekanike (France), Universiteti i Dublinit (Irlanë), etj.

Viti 2005 shënoi ristrukturimin e programeve të studimit të UPT, bazuar në “Deklaratën e Bolonjes”. Këtë vit filloi implementimi i programeve të studimit në dy nivele: në nivelin 3 vjeçar (Bachelor) dhe në nivelin pasues 2 vjeçar (Master).

Viti 2007 e gjen UPT me gjashtë fakultete: përveç katër fakulteteve ekzistues krijohen Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI) dhe Fakulteti i Formimit të Përgjithshëm (FFP). Nga ana tjetër Ligji “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Nr. 9741, Dt 21.05.2007, detyroi rishikimin e fundit të strukturs organizative të UPT, pasi në bazë të tij prane UPT u vendosën dy institute: Instituti i Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (INEUM) dhe Instituti i Gjeo-Shkencës (INGJSH).

Tani UPT, pervec sherbimit te mesimdhenies (programe studimi te nivelit te pare, programe studimi te nivelit te dyte, dhe programe studimi te nivelit te trete deri ne doktorature) dhe kerkimit shkencor, ofron dhe sherbime te tjera per te tretet, vecanrisht nga dy institutet e bashkangjitur atij.

\*  
\*   \*  
\*

Periudha 1951 – 2008 eshte karakterizuar jo vetem me nje rritje sasijore por gradualisht edhe nga nje rritje e nivelit te cilesise. Megjithate cilesia e sherbimeve qe ofron UPT nuk eshte ne nivelin qe kerkon koha, qe kerkon bshkerenditja dhe integrimi i aktiviteteve te ketij institucioni, sidomos i aktivitetit mesimdhenes, me aktivitetet qe zhvillohen ne universitetet europiane.

Ligji “Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise”, Nr. 9741, Dt 21.05.2007, e shpreh qarte theksi i madh qe i vihet problemit te cilesise dhe te sigurimit te saj ne institucionet e arsimit te larte qe ne Nenin 1 “Qellimi i ligjit”:

“Ky ligj ka per qellim ... te rregulloje aspekte ... te sigurimit te cilesise ne institucionet e arsimit te larte ne perputhje me standardet europiane ...”

Ne kete Ligj problemet e cilesise, te sigurimit te cilesise, te vleresimit te brendshem dhe te vleresimit te jashtem si dhe te akreditimit jane trajtuar per here te pare ne mbi 18 nene, nga me te rendesishmit e Ligjit.

Pervec ketij ligji, trajtimi i cilesise ne UPT eshte bere domosdoshmeri edhe per arsyt e meposhtme:

- Grumbullimi i konsiderueshem i mjaft problemeve te ndryshme qe kerkojne trajtimin paresor te cilesise, si rritja e numrit te studenteve (nga 5000 studente ne vitin 2004 ne afer 8000 studente ne vitin 2008); rritja e numrit te pedagogeve, te jashtem dhe te brendshem (nga rreth 500 ne 2004 ne rreth 750 ne 2008), rritja e numrit te pedagogeve me tituj dhe grada shkencore (numri i profesoreve, prof. te asociuar dhe doktoreve, nga rreth 270 ne 2004 ne mbi 300 ne 2008); rritja e buxhetit dhe e te ardhurave (ne total nga rreth 300 mln leke ne 2004 ne rreth 800 mln leke ne 2008); shtimi i numrit te fakulteteve (nga 4 ne 2004 ne 6 ne 2008) dhe atashimi i dy instituteve kerkimore; shtimi i programeve te studimit, duke arritur ne vitin 2008 ne 17 diploma DNP dhe 17 diploma DND; etj.
- Grumbullimi i nje pervoje pozitive 50 – 60 vjeçare ne fakultetet e UPT, vecanrisht ne mesimdhenie.
- “Presioni” qe ushtron niveli i larte i cilesise ne universitetet europiane mbi stafet akademike te UPT.
- Kerkesat ne rritje te studenteve per njohjen apo ekuivalentimin e njohurive ose diplomave te UPT nga universitetet europiane dhe anasjelltas.
- Neni 90 i Ligjit, i hyre ne fuqi ne qershor 2007, i cili shpall se:

“Institucionet e Arsimit te Larte, te cilet jane krijuar para hyrjes ne fuqi te ketij ligji duhet t’i nenshtrohen procesit te vleresimit dhe akreditimit sipas ketij ligji brenda tre vjeteve nga hyrja ne fuqi e tij. ....”

Nga ana tjeter, ne UPT ekzistojne mundesira jo te vogla te cilat lejojne ndermarrjen e veprimeve jo vetem taktike por dhe strategjike ne drejtim te permiresimit te cilesise. Nder keto mundesi mund te permenden:

- Vete permbajtja e Ligjit “Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise”, Nr. 9741, Dt 21.05.2007 si dhe e akteve nenligjore ( Vendime te Keshillit te Ministrave, Urdhera dhe udhezime te Ministrit dhe MASH), qe jane nxjerre mbi bazen e tij. Te gjitha keto materiale jane te mbushur me standarde te ndryshme qe udhezojne trajtimin e cilesise ne UPT.

- Po per te njejten arsye, Statuti dhe Rregullorja e UPT, rregulloret e fakulteteve, etj., jane dokumente shume te rendesishme ku mund dhe duhet bazuar per trajtimin e permiresimeve cilesore ne UPT.
- Pervoja rreth 60 vjeçare e stafeve akademike te UPT, sidomos ne aktivitetin mesimdhene.
- Arritja e kualifikimit te pergjithshem profesional te stafeve akademike prane universiteteve europiane dhe ne veçanti i nje pjese te stafeve te fakulteteve ne fushen e cilesise dhe te vleresimit te cilesise.
- Mundesia e kualifikimit te vleresuesve te UPT prane Agjencise Publike te Akreditimit te Arsimit te Larte per vleresimin e brendshem te cilesise.
- Mbeshtetja financiare ligjore, mbi bazen e Nenit 73 “Burimet e Financimit te Institucioneve publike te Arsimit te Larte”, te Ligjit “Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise”, ne te cilin UPT garantohet se:

“ ..... 2. Keshilli i Ministrave, permes MASH u jep Institucioneve publike te Arsimit te Larte fonde per permbushjen e misionit te tyre sipas standardeve. ....”

## QELLIMET E PROGRAMIT

Programi duke qene nje bashkesi komplekse aktiviteteve sekuenciale por dhe te integruar synon te arrije ne disa objektiva te natyrate te ndryshme. Nder synimet kryesore te programit jane planifikuar:

- Ngritja e nivelit te pergjithshem cilesor te aktiviteteve qe zhvillohen ne UPT
- Arritja e nje niveli te pranueshem te stabilitetit te cilesise se aktiviteteve te UPT.
- Permiresimi i vazhdueshem i cilesise se aktiviteteve te UPT.
- Njohja e jashtme e nivelit te pranuar te cilesise ne aktivitetet e UPT dhe e permiresimit te saj te vazhdueshem, nepermjet procesit te akreditimit.
- Rritja e nivelit te kultures se cilesise ne UPT.

## OBJEKTIVAT E PROGRAMIT

Ne Programin e Permiresimit te Cilesise ne Aktivitetet e UPT jane vendosur objektiva te lidhur me cilesine ne aktivitetet qe ofron ky institucion i arsimit te larte.

Nepermjet realizimit te Programit te Permiresimit te Cilesise ne Aktivitetet e UPT jane planifikuar te arrihen objektivat kryesore, te paraqitur me poshte.

### Objektivi strategjik

Rritja e vazhdueshme e nivelit te cilesise nepermjet rritjes se shkalles se pergjegjesis se per kete rritje, zbatimit te disipline se cilesise dhe kontrollit te cilesise ne te gjitha nivelet hierarkike te strukture organizative te UPT deri ne krijimin e kultures europiane te cilesise ne te gjithe institucionin.

### Objektivat institucionalndertues

Ngritja dhe funksionimi i Qendres se Sigurimit te Brendshem te Cilesise prane UPT.  
Ngritja e keshillave te diplomimit te programeve te studimit ne UPT

### Objektivi themelor

Arritja e standardeve institucionale ne sherbimet baze qe ofron UPT:

- Programet e Studimit.

- Kerkimin Shkencor.
- Sherbimet per te Tretet.

## Objektivi i detyrimit ligjor

Arritja e akreditimit institucional te UPT.

## PARIMET E NDERTIMIT DHE TE APLIKIMIT TE PROGRAMIT

Per te orientuar ndertimin dhe aplikimin e Programit te Permiresimit te Cilesise ne Aktivitetet e UPT me efektivitet dhe eficence, jane formuluar keto parime:

1. Njohja e kerkesave evropiane per ndertimin e programeve dhe projekteve ne fushen e Arsimit te Larte.
2. Perfshirja e personelit te UPT ne ndertimin dhe, sidomos gjithperfshirja, ne aplikimin e Programit.
3. Njohja ne nivelin e kerkuar e koncepteve themelore te cilesise ne arsimin universitar.
4. Njohja e niveleve te cilesise ne modelin e zgjedhur te institucionit universitar europian.
5. Njohja e thelle e Ligjit "Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise", Nr. 9741, Dt 21.05.2007, e akteve nenligjore qe e mbeshtetin ate( Vendime te Keshillit te Ministrave, Urdhëra dhe udhezime te Ministrit dhe MASH), e Statutit dhe Rregullores se UPT, e rregulloreve te fakulteteve dhe instituteve te UPT dhe e rregulloreve te tjera te ketij institucioni, si pikenisje dhe nje nga burimet kryesore te trajtimit te aktiviteve te Programit.
6. Njohja e kerkesave te sotme dhe te perspektives qe shtrojne palet e interesuara ndaj UPT dhe perqendrimi tek njohja, bashkepunimi dhe partneriteti me klientet e UPT.
7. Njohja dhe analiza e mire e gjendjes cilesore ekzistuese ne aktivitetet baze qe ofron UPT.
8. Realizimi me efektivitet dhe eficence i aktiviteve te Programit.
9. Aplikimi i metodës së sistemit, nepermjet identifikimit, kuptimit dhe menaxhimit te proceseve te lidhura si nje sistem.
10. Aplikimi i ciklit PDCA ne projektet e Programit.
11. Realizimi i transparences se plote dhe i informimit te vazhdueshem per permbajtjen, ecurine dhe rezultatet e perfundimit te projektit.

## SKEMA LOGJIKE E PERMBAJTJES SE PROGRAMIT

Laitmotivi, ideja themelore, qe pershkron te gjithe Programin eshte: "standardi, si element mbartes i cilesise, arritja e standardit dhe vleresimi i arritjes se tij".

Zberthimi dhe shtrirja e kesaj ideje ne realitetin e sherbimeve qe ofron UPT (mesimdhenie, kerkim shkencor, aktivite per te trete) çon ne kete zinxhir logjik te ecurise se permiresimit te cilesise (figura 1):




Figura 1. Zinxhiri logjik i permiresimit te cilesise nepermjet trajtimit te standardeve

Mbi kete baze, eshte pranuar linja llogjike e trajtimit te standardeve, e cila kalon neper keto tri etapa:

1. Fiksimi i niveleve te detyrueshme dhe te arritshme te cilesise ne standarde.



2. Evidentimi i gjendjes konkrete te cilesise referuar nivelit te cilesise te fiksuar ne standarde.
3. Vendosja e nivelit me te larte cilesor nepermjet rishikimit intensiv dhe ekstensiv te standardeve.

Keto tri etapa kane percaktuar permbajtjen e tre projekteve te Programit: te Projektit Nr.1 (PR. 1), Projektit Nr. 2 (PR. 2) dhe Projektit Nr. 3 (PR. 3).

## KOHEZGJATJA E PROGRAMIT

Ne percaktimin e kohezgjatjes se gjithe Programit dhe te kohezgjatjeve te projekteve perberes te tij jane marre ne konsiderate keto kriteret:

- Kohezgjatja sa me e shkurter e mundur, duke patur parasysh nivelin aktual te cilesise si dhe faktin se procesi i permiresimit te cilesise eshte nje proces i vazhdueshem.
- Burimet njerezore, materiale teknike dhe financiare ne dispozicion.
- Skadencia e detyrimit ligjor qe rrjedh nga Ligji “Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise”, Nr. 9741, Dt 21.05.2007, Neni 90.
- Mbimbulimi kohor i mundshem i kohezgjatjeve te projekteve te Programit.

Mbi keto baze, eshte planifikuar nje kohe e pergjithshme e ndertimit dhe e aplikimit te Programit prej rreth 3 vjetesh. Kohezgjatjet e projekteve perberes PR 1, PR 2, PR 3 (duke mos lene menjane dhe kohezgjatjen e procesit sensibilizues-informues PSI ) pa periudhen e mbimbulimeve jane paraqitur ne figuren 2.




Figura 2. Idea e mbimbulimeve taktike ne kohe te procesit te sensibilizimit dhe projekteve te Programit

## **PJESA E 2-TE: PROCESI SENSIBILIZUES-INFORMUES DHE PROJEKTET E PROGRAMIT**

Arritja e objektivit themelor te Programit “Permiresimi i Cilesise ne Aktivitetet e UPT” dhe, gradualisht, arritja e objektivit strategjik te institucionit, qe lidhet me kulturen e cilesise, kerkon qe nga njeri projekt ne projektin pasardhes te pershkohet nje rruge relativisht e gjate, per te arritur plotesisht ne nivelet cilesore te universiteteve europiane.

### **PROCESI I FUSHATES SENSIBILIZUESE-INFORMUESE**

Duke qene se ky eshte i pari program ne lidhje me cilesine, qe ndermerret ne menyre te organizuar dhe me pergjegjesi te pergjithshme institucionale, ndertimi dhe aplikimi i projekteve sekuenciale te permiresimit te cilesise eshte paraprire nga nje fushate gjithinstitucionale sensibilizuese-informuese.

Procesi i sensibilizimit dhe informimit (dhjetor 2008 – mars 2009) planifikohet te perfshije te gjithë personelin e strukture organizative te UPT si dhe studentet.

Jane parashikuar forma dhe permbajtje te ndryshme sensibilizuese- informuese. Aktivitete te vecanta sensibilizuese do te zhvillohen me:

- Rektoratin e UPT.
- Senatin e UPT-
- Administraten qendrore te UPT.
- Dekanatet/drejtorite e fakulteteve/instituteve.
- Departamentet/sektoret e fakulteteve/instituteve.
- Punonjesit e administrates se fakulteteve/instituteve.
- Studentet e fakulteteve.

Realizimi i procesit te sensibilizim-informimit, duke paraprire zhvillimin e projekteve te programit, parashikohet qe te shenoje dhe nje ngritje relativisht te vogel te nivelit real te cilesise ne aktivitetet qe zhvillohen ne UPT, kundrejt nivelit aktual real te cilesise, te arritur nga veprimi i “standardeve informale” (figura 3). Ne kete ngritje te nivelit te cilesise se aktiviteteve do te ndikojne keta faktore:

- Krijimi i nje ambienti te pergjithshem te sensibilizuar dhe te informuar per problemin e cilesise ne UPT.
- Rritja e shkalles se ndergjegjesimit per domosdoshmerine e trajtimit te cilesise ne punen e personelit te UPT.
- Rritja e shkalles se pergjegjesise personale tek personeli i UPT per te realizuar më me cilesi detyrat.
- Rritja e shkalles se disiplines per te realizuar ne sasine dhe cilesine e nevojshme detyrat e ngarkuara.

Meqenese ka nje ndikim te pazevendesueshem, sensibilizimi dhe informimi perkates do te paraprije dhe shoqeroje edhe implementimin e serise se projekteve te Programit.

### **PROJEKTI PR 1: NDERTIMI I SISTEMIT TE STANDARDEVE INSTITUCIONALE TE UPT**

Kontributi i pare i Projektit te pare PR 1(prill – tetor 2009) ka te beje me institucionalizimin e keshillave te diplomimit te çdo programi studimi. Ngritja e keshillave te diplomimit do te krijojë mundesi me te mira sidomos per krijimin dhe rishikimin efektiv te programeve te studimit, si dhe per ndertimin dhe aplikimin me pergjegjesi te caktuar institucionale te nensistemit te standardeve te programit te studimit.

Ideja baze e Projektit PR 1 eshte fiksimi i niveleve te detyrueshme dhe te arritshme te cilesise ne standardet institucionale te aktiviteteve qe zhvillohen ne UPT.

Standardet qe do te ndertohen dhe vendosen ne kete Projekt do te jene standarde institucionale, ne kuptimin qe do te kene ne bashkesine e tyre standardet shteterore, te cilet jane baze per akreditimin institucional dhe te programeve te studimit, si dhe standardet e tjere qe do te burojne nga domosdoshmeria dhe mundesite konkrete qe ekzistojne per te realizuar aktivitetet e ndryshme ne UPT, sipas cilesise se planifikuar.




Figura 3. Nivelet cilesore relative reale para, gjate dhe pas aplikimit te Programit

Trajtimi i standardeve do te behet ne kuadrin e nje sistemi standardesh institucionale te perbere nga nensistemet perkatese. Ndertimi i Sistemit dhe nensistemeve te standardeve do te marre parasysh:

- Ekzistencen e aktiviteteve baze qe zhvillohen ne UPT (mesimdhenia, kerkimi shkencor, sherbimi per te trete).
- Stabilitetin ne cilesine e aktiviteteve qe zhvillohen ne UPT.
- Permiresimin e vazhdueshem te cilesise ne aktivitetet qe zhvillohen ne UPT.

Ne UPT aktiviteti me voluminoz dhe me kryesori eshte mesimdhenia ne programet perkatese te studimit. Ndertimi i nensistemit te standardeve te programeve te studimit do te paraprihet nga:

- ngritja e keshillave te diplomimit te programeve te studimit,
- organizimi i ketyre keshillave,
- plotesimi i dokumentacionit te funksionimit te tyre.

Per nxjerrjen dhe formulimin e standardeve do te merren ne konsiderate keto burime kryesore:

- Ligji “Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise”, Nr. 9741, Dt 21.05.2007 dhe aktet nenligjore, qe mbeshtesin kete Ligj.
- Standardet europiane te sigurimit te cilesise ne arsimin e larte.
- Standardet e universiteteve te vecante europiane, posacerisht te universiteteve politeknike italiane, te cilet jane zgjedhur si modele te programeve te studimit te UPT.
- Idete e anetareve te stafeve dhe te studenteve te UPT, qe shprehin cilesine potenciale ne aktivitetet e ndryshme dhe qe jane pjese e pervojës se grumbulluar ne UPT.
- Burime te tjere.

Krahas formulimit te standardeve, nje rendesi e madhe do i kushtohet dhe dhenies se udhezimeve si dhe menyres se matjes se zbatimit te tyre.

Output kryesor i Projektit PR 1 do te jete dokumenti “Permbledhja e Standardeve Institucionale te aktiviteve qe ofron UPT”.

Parashikohet qe, gjate realizimit te Projektit PR 1, niveli i pergjithshem i cilesise ne aktivitetet qe zhvillohen ne UPT te rritet (figura 3) per keto arsye:

- Kualifikimi i stafeve akademike dhe ndihmese nepermjet zhvillimit te seminareve te shkurter te trainimit mbi standardet ne arsimin universitar.
- Vazhdimi i sensibilizimit dhe informimit per punen e kryer ne ndertimin e Projektit PR 1 dhe aktivitetin e ardhshem te vleresimit te brendshem.
- Vazhdimi i rritjes se shkalles se ndergjegjesimit dhe te pergjegjesise per cilesine ne aktivitetet qe zhvillohen.
- Forcimi i disiplines dhe i kerkeses se llogarise ne lidhje me cilesine e aktiviteve qe zhvillohen.

Niveli i pergjithshem i cilesise se standardeve institucionale te UPT, do te jete me i larte se sa niveli i cilesise qe vendosin standardet shtetore, pasi minimumi do te vendosen standarde dhe ne nenaktivitete, nenaktivitete te cilet nuk i kane marre akoma ne konsiderate standardet shtetore. Por eshte e pritshme qe niveli real i pergjithshem ne aktivitetet qe zhvillohen ne UPT, pas implementimit te Projektit PR 1, mund te jete me i ulet se sa niveli qe percaktojne standardet shtetore, gjë qe parashikohet qe te kapercehet nepermjet punes dhe investimeve qe do te kryhen gjate realizimit te Projektit PR 2.

## **PROJEKTI PR 2: NGRITJA E QENDRES SE SIGURIMIT TE BRENDSEM TE CILESISE. VLERESIMI I BRENDSEM I CILESISE NE UPT SIPAS STANDARDEVE INSTITUCIONALE TE TIJ**

Projekti PR 2 (nentor 2009 – tetor 2010) do te realizohet duke patur ne bazen e tij, se pari, ndertimin e Qendres se Sigurimit te Brendshem te Cilesise dhe, se dyti, evidentimin e gjendjes konkrete te cilesise, drejtuar nga kjo Qender, nepermjet vleresimit te brendshem te cilesise, referuar nivelit te cilesise te fiksuar ne standardet institucionale te vendosur ne Projektin PR 1.

Qendra e Sigurimit te Brendshem te Cilesise (QSBC) do vleresoje periodikisht efikasitetin e aktiviteve mesimdhense, kerkimore shkencore si dhe te veprimtarive administrative dhe financiare te institucionit. Ajo do kete autonomi operative dhe akses ne te gjitha te thenat e UPT.

Ngritja QSBC dhe ushtrimi normal i detyrave të kësaj Qendre do të kërkojë realizimin e këtyre aktiviteteve, në kuadrin e realizimit të pjesës së parë të Projektit PR 2:

- Përgatitjen e rregullores dhe procedurave të vlerësimit të brendshëm të QSBC.
- Përgatitjen e strukturës së QSBC dhe plotësimin e efektivitetit të saj.
- Sigurimin e ambienteve dhe paisjeve të QSBC.
- Kualifikimin e efektivitetit të QSBC.

QSBC do të shërbejë si baza institucionale e specializuar për implementimin e pjesës tjetër të Programit.

Objektivi tjetër kryesor në këtë Projekt do të jetë vlerësimi i brendshëm institucional. Procesi i vlerësimit të brendshëm përbën pjesën e dytë, me voluminozë, të Projektit PR 2.

Duke patur parasysh vëllimin e punës dhe përvojën e vogël në realizimin e këtij procesi, në Projektin PR 2 janë parashikuar këto aktivitete kryesore:

- Studimi i planit të punës për vlerësimin e brendshëm institucional.
- Ngritjen e grupeve të vlerësuesve të brendshëm.
- Kualifikimi i vlerësuesve të brendshëm.
- Realizimi i vlerësimit të implementimit të standardeve të programeve të studimit dhe të standardeve të sistemit të cilësive.
- Përgatitja e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm.
- Nderhyrjet e nevojshme për të plotësuar standardet institucionale të paplotesuara dhe verifikimet përkatëse.
- Krijimi i “Çmimit të Cilësive” për programet e studimit që plotësojnë standarde me nivel më të lartë institucionale dhe aplikimi i këtij çmimi shoqëruar me stimulim moral dhe materiale kolektive.

Niveli real i cilësive së përgjithshme në aktivitetet e UPT, në përfundim të Projektit PR 2, pritet të rritet kundrejt nivelit real të arritur në fund të realizimit të Projektit PR 1 (figura 3) sepse:

- Vlerësimi i brendshëm do të ushtrojë “presion” në drejtim të përmirësimit të ushtrimit të kontrollit dhe të rritjes së mobilizimit dhe disiplinës në realizimin e aktiviteteve të ndryshme: gjatë realizimit të procesit të vlerësimit vëmendja kryesore e të gjithëve pritet të përqendrohet në këtë drejtim.
- Është parashikuar investimi i nevojshëm që, minimumi, të plotësohen të gjithë standardet shtetërore.

### **PROJEKTI PR 3: ARRITJA E NIVELEVE TË PLANIFIKUARA TË CILËSISË NË UPT, NEPERMJET RRRITJES INTENSIVE DHE EKSTENSIVE TË NIVELIT TË STANDARDEVE INSTITUCIONALE TË MIRATUARA**

Projekti PR 3 (nëntor 2010 – dhjetor 2011) përbëhet nga dy pjesë. Në pjesën e parë do të vendosen nivele të reja sipas një rritje optimale cilësore- ekonomike, ndërsa në pjesën e dytë do të kryhet vetëvlerësimi një vjeçar i UPT.

Në këtë Projekt bëhet përpjekja e parë për të rritur nivelin e planifikuar të cilësive në aktivitetet e UPT, në baze të studimit të kujdeshëm dhe objektiv të nevojave që ka dhe mundësi që disponon UPT. Rritja optimale e nivelit të cilësive do të kryhet si në drejtimin intensiv, në kuptimin e përmirësimit të parametrave të standardeve të ndryshëm, ashtu dhe në drejtimin ekstensiv, në

kuptimin e shtrirjes se metejshtme te standardeve edhe ne ato aktivitete, te cilet nuk u standardizuan ne Projektin PR 1.

Outputi i pjeses se pare do te jete “Permbledhja e Standardeve Institucionale te aktiviteve qe ofron UPT”, e rishikuar.

Per Vleresimi i Brendshem, te kryer ne pjesen e dyte te Projektit, do te kete nje kualifikim dhe pervoje te mjaftueshme, te grumbulluar ne Projektin PR 2, si rrjedhoje parashikohet qe ai te kryhet me lehte dhe me shpejte.

Natyrisht qe, ne perfundim te realizimit te Projektit PR 3, pritet qe niveli i pergjithshem real i cilesise ne aktivitetet e UPT te pesoje rritjen perkatese.

**Shenim i rendesishem:** Bazen e Programit e perbejne tre projektet: PR 1, PR 2, PR 3. Te tre keta projekte kane permbajtje te pavarur dhe periudha perkatese kohore, ndertimi dhe implementimi, jo te vogla, pavaresisht se per perfitim kohor taktikisht eshte pranuar nje fare mbimbulimi.

Programi, si eshte konceptuar, si eshte ndertuar dhe si do te realizohet, eshte nje bashkesi projektesh te pafund, pasi i tille eshte edhe procesi i permiresimit te cilesise ne aktivitetet dhe sherbimet qe ofron UPT. Realizimi i tre projekteve me nje sekuence logjike, teknike dhe organizative te qarte, do te krijojte ate baze dhe pervoje te nevojshme per ndermarrjen e projekteve te tjere ne vazhdim pas vitit 2011 (figura 3). Pra Projektin PR 3 eshte parashikuar ta pasoje Projekti PR 4, me te njejtin emertim si PR 3, e keshtu ne vazhdim.

## **DOKUMENTACIONI I PROGRAMIT**

### **Dokumenti 1/5**

Ne kete dokument pershkruhet baza e Programit “Permiresimi i Cilesise ne Aktivitetet e UPT”: qellimet, objektivat, burimet dhe idete esenciale te procesit te sensibilizim-informimit dhe te tre projekteve, qe bejne pjese ne kete Program.

### **Dokumenti 2/5**

Ky dokument perben formulimin e Procesit te Sensibilizimit dhe Informimit, qe sherben per te planifikuar, organizuar, drejtuar dhe kontrolluar realizimin e aktiviteve dhe nenaktiviteve te ketij Prosesi.

### **Dokumenti 3/5**

Dokumenti perben formulimin e Projektit PR 1 “Ndertimi i sistemit te standardeve institucionale te UPT”, qe sherben per te planifikuar, organizuar, drejtuar dhe kontrolluar realizimin e aktiviteve dhe nenaktiviteve te ketij Projekti.

### **Dokumenti 4/5**

Dokumenti perben formulimin e Projektit PR 2 “Ngritja e qendres se sigurimit te brendshem te cilesise. Vleresimi i brendshem i cilesise ne UPT sipas standardeve institucionale te tij”, dhe sherben per te planifikuar, organizuar, drejtuar dhe kontrolluar realizimin e aktiviteve dhe nenaktiviteve te ketij Projekti.

## **Dokumenti 5/5**

Ky dokument perben formulimin e Projektit PR 3 “Arritja e niveleve te planifikuara te cilesise ne UPT, nepermjet shtrirjes se plote te standardeve institucionale te miratuara”, qe edhe ky sherben per te planifikuar, organizuar, drejtuar dhe kontrolluar realizimin e aktiviteve dhe nenaktiviteve te ketij Projekti.



## **PJESA E 3-TE: NEVOJAT DHE BURIMET PER REALIZIMIN E PROGRAMIT**

### **Nevojat financiare**

Ne ndertimin dhe implementimin e Procesit PSI dhe te tre projekteve te Programit tre vjeçar nevoiten te kryhen keto pagesa dhe shpenzime:

- Pagesat per pjesemarresit ne ndertimin dhe implementimin e Programit.
- Shpenzimet per kualifikimin e pjesemarresve ne ndertimin dhe implementimin e Programit.
- Shpenzimet materialo-teknike: materiale konsumi qe do te blihen, paisjet, tavolinat, dollape, stenda, telefona, kompjutera, etj.
- Shpenzimet infrastrukturore: sistemi telefonik, sistemi informatik, etj.
- Shpenzimet teknologjike: paisjet e aplikimit te teknologjive bashkekohore mesimdhense, etj.
- Shpenzimet per permiresimin e kushteve ambientale.

### **Burimet**

Per te perballuar pagesat, shpenzimet dhe nevojat e tjera qe sigurojne arritjen e objektivave te Programit, UPT do te vere ne dispozicion keto burime:

- Burimet njerezore: pjesemarresit ne ndertimin dhe implementimin e Programit do te jene, pergjithsisht, anetare te stafeve akademike dhe punonjes te administrates te fakulteteve/instituteve.
- Burimet financiare: fondi me nje shume totale prej ..... lekesh, te siguruar nga buxheti disponibel i UPT. Pervec kesaj shume, UPT do te beje te gjitha perpjekjet per te siguruar financime nga drejtime te ndryshme.
- Burimet materialo-teknike, teknologjike dhe infrastrukturore ekzistuese ne UPT.

Fondi i Programit do te shperndahet sipas Procesit PSI dhe tre projekteve, ne perputhje me nevojat financiare qe kane ata.

Pagesat dhe shpenzimet do te kryhen ne perputhje me legjislacionin dhe normat perkatese:

Pagesa per pjesemarresit qe do te kontribuojne ne ndertimin dhe implementimin e Programit do te kryhet ne baze te kohes se punes se kryer (ne ore) dhe pages orare personale te pjesemarresit. Pagesa per çdo pjesemarres, qe do te kontribuojne ne projekt, do te kryhet ne rast se pjesemarresi do te kete plotesuar 1500 ore pune vjetore me aktivitete te tjera, jashte ketij Programi.

Per te gjitha shpenzimet do te kryhen regjistrimet ne formularet perkates.



## SHTOJCA: FJALORTHË

Projekti:	Plan menaxherial, qe shpreh nje bashkesi aktivitetesh dhe qe ka objektive te perseritshem.
Programi:	Plan kompleks menaxherial, qe shpreh nje bashkesi projektesh.
Misioni:	Elementi fillestar i hierarkise se planeve te nje Institucioni te arsimit te larte qe vendos synimin perfundimtar te institucionit, duke percaktuar aty tipin e sherbimit dhe klientet.
Universiteti:	Institucion me nje strukture, te perbere dhe te integruar, qe realizon arsimim te larte, zhvillim te dijeve, te shkences, profesioneve dhe transmeton njohuri ne fusha dhe disiplina, shkencore dhe profesionale.
Fakulteti:	Njesi kryesore mesimore-shkencore e universitetit, qe bashkerendon mesimdhenien, kerkimin shkencor ne fusha mesimore-kerkimore, te peraferta ose te nderthurura.
Departamenti/Qendra e kerkimit:	Njesi baze mesimore-kerkimore e universitetit, qe perfshin fusha kerkimi homogjene dhe grupon disiplinat mesimore respektive.
Studenti:	Personi qe rezulton i regjistruar ne nje program studimi.
I diplomuari:	Studenti qe ka perfunduar me rezultatet e kerkuara pozitive programin e studimit.
Programi i Studimit Universitar:	Teresia e njohurive dhe e aftesive profesionale qe fiton studenti gjate kryesrjes se studimeve universitare.
Drejtuesi i programit te studimit:	Pedagog me titullin Profesor, i cili ka detyren dhe pergjegjesine qe te menaxhoje (planifikoje, organizoje, drejtoje, kontrolloje) realizimin e programit te studimit ne baze te burimeve qe i vihen ne dispozicion dhe te marre masat e duhura per arritjen e objektivave didaktike dhe te qellimit te ketij programi studimi.
Politika e cilesise	Dokument planifikues ku shprehen ne menyre formale nga ana e drejtorise se institucionit objektivat e lidhura me cilesine si dhe drejtimet, rruget dhe menytrat per arritjen e ketyre objektivave.
Objektivi strategjik i cilesise	Objektivi qe lidhet me cilesine dhe qe planifikohet qe

	te arrihet per nje periudhe afatgjate kohe.
Objektivi institucional ndertues i cilesise	Objektivi i lidher me ngritjen e hallkes organizative qe do te trajtoje problemet e cilesise ne institucion.
Objektivi themelor i cilesise	Objektivi i cilesise qe perfaqeson arritjen e laitmotivit te aktiviteteve ne nje program ose projekt
Cilesia ne arsimin e larte	Bashkesia e karakteristikave te procesit (te mesim-dhenies, te kerkimit, te sherbimeve te tjera), qe sigurojne aftesine per te kenaqur kerkesat e te gjithë paleve te interesuara.
Palet e interesuara per arsimin e larte	Te gjithë organizmat, shoqeria, entet, ndermarrjet ose persona te veçante qe kane interesa ne zhvillimin e aktivitetit mesimor –shkencor te universitetit dhe ne figuren profesionale te te diplomuarit. Ketu bejne pjese: <ul style="list-style-type: none"> <li>- klientet;</li> <li>- shteti si financuesi kryesor dhe ente te tjere financues;</li> <li>- stafi akademik dhe ai mbeshitetes (ndihmes);</li> <li>- furnizuesit dhe partneret;</li> <li>- shoqeria civile ne kompleksitetin e saj.</li> </ul>
Klientet e arsimit te larte	- Studentet, si perdorues te drejtperdrejte te sherbimit mesimdhene (formues) te programit te studimit; - Perdoruesit ose perfituesit finale (ndermarrjet, institucionet, persona te veçante), te cilet perdorin ose qe do te mund te nxirrin perfitime nga profesionaliteti i fituar nga studenti ne programin e studimit, nga kerkimishkencor, nga sherbimet e tjera.
Standardi ne arsimin e larte	Nje kerkese ose nje sistem kerkesash apo parametrash te pranuar si “norme” shtetore apo institucionale per veprimtarine e sektoreve apo institucioneve te ndryshem ne arsimin e larte. Standardet e arsimit tregojne nivelin e cilesise se punes nen te cilin ajo nuk duhet te bjere, por nese do te ish e mundur, te ngrihej).
Standardet shtetore te arsimit te larte	Standardet e arsimit te larte, te ndertuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkences dhe te publikuar prej saj nepermjet Ligjit “Per arsimin e larte ne Republiken e Shqiperise” dhe akteve nenligjore qe mbeshetin kete Ligj.
Standardet institucionale te arsimit te larte	Standarde te arsimit te larte, te ndertuar nga institucioni i arsimit te larte dhe te publikuar nepermjet statutit dhe te gjitha llojeve te rregulloreve qe nxjerr ky institucion. Kur institucioni vendos te akreditohet, atehere ne perberje te standardeve institucionale duhet te

perfshihen edhe standardet shteterore.

Kerkesat:

Bashkësia e nevojave dhe pritshmerive qe klientet ose palet e tjera te interesuara kane per nje produkt ose nje sherbim. Kerkesat mund te jene te shprehura (eksplicite), te pashprehura (implicite) ose te fshehta (latente):

- kerkesat e shprehura jane kerkesat qe shprehen drejtperdrejt nga palet e interesuara;
- kerkesat e pashprehura jane ato kerkesa per te cila palet e interesuara nuk kerkojne shprehimisht qe te kenaqen apo plotesohen, meqenese ato nenkuptohen;
- kerkesat e fshehta jane ato kerkesa te cilat palet e interesuara nuk jane ne gjendje qe ti shprehin sepse nuk i ndejne si te tilla deri ne momentin ne te cilin nuk mund te zbulojne ose te verifikojne perfitimet qe rrjedhin nga kenaqja ose plotesimi i tyre.

Specifikimi:

Dokumenti qe paraqet ose qe shpall kerkesat.

Menaxhimi i cilesise ne arsimin e larte

Bashkësia e aktiviteteve te koordinuara te planifikimit, realizimit, verifikimit te realizimit, analizes se rezultateve te verifikimit (per marrjen e masave apo veprimeve korigjuese dhe masave apo veprimeve parandaluese), te cilet synojne mbajtjen nen kontroll te institucionit te arsimit te larte ne lidhje me cilesine.

Sigurimi i brendshem i cilesise

Pjese e menaxhimit te cilesise, e fokusuar ne dhenien e besueshmerise se kerkesat e cilesise do te kenaqen.

Vleresimi i brendshem

Rishqyrtim i gjithanshem dhe sistematik i nje/disa aktiviteteve dhe/ose rezultateve te arritur nga institucioni kundrejt standardeve, objektive apo mberritjeve te planifikuara. Ai ndihmon ne identifikimin e pikave ose zonave qe kerkojne permiresim dhe ne vendosjen e perparësive gjate ketij procesi.

Vetevleresimi eshte vleresimi qe ben institucioni me inisiativen dhe nen pergjegjesine e tij (duke e ideuar, duke e organizuar dhe duke e drejtuar realizimin e ketij aktiviteti vete per qellimet e tij te brendshme).

Vleresimi i jashtem

Procesi i evidentimit real te nivelit te cilesise se nje programi studimi ose te nje Institucioni te Arsimit te Larte. Ky vleresim kryhet nga një grup ekspertësh të jashtëm të zgjedhur dhe drejtuar nga Agjensia e Akreditimit të Arsimit të Lartë. Gjate procesit grupi vlerëson nëse Programet e Studimit apo Institucioni

	kane plotësuar standardet e paravendosura. :
Akreditimi ne arsimin e larte	Procesi i vendimmarrjes ne lidhje me vleresimin (vleresimi i brendshem dhe vleresimi i jashtem) e cilesise.
Akreditimi i programit te studimit	Akreditimi, i bazuar ne vleresimet (i brendshem dhe i jashtem) e nje programi studimi, sipas standardeve shteterore qe i referohen programeve te studimit.
Akreditimi institucional	Akreditimi, i bazuar ne vleresimet (i brendshem dhe i jashtem) e pergjithshme te nje institucioni, sipas te gjithe standardeve shteterore.
Cikli PDCA	Inicialet ne gjuhen angleze te funksioneve te menaxhimit te cilesise ne nje aktivitet (proces) qe parashikojne planifikimin (Plan), kryerjen (Do), kontrollin (Check) dhe veprimet e permiresimit (Act), veprimet korrigjuese dhe veprimet parandaluese.
Procesi/aktiviteti:	Nje sere veprimtarish, te ndervarura midis tyre, qe duke u nisur nga nje fare input-i/te pesojne transformime te shoqeruara me shtim vlere, duke arritur ne output-in/et perkates. Input-et dhe output-et mund te jene objekte materiale, persona, informacione ose dokumente te ndryshme.
Efektiviteti:	Grada e realizimit te aktivitetit te planifikuar dhe e Arritjes se rezultateve te planifikuara. Shpesh efektiviteti kuptohet si aftesia per te zgjedhur objektivat e pershtatshem dhe mjetet e duhura per arritjen e tyre, aftesia per te bere gjerat qe duhet, ne menyren dhe kohen e duhur.
Eficensa:	Raporti ndermjet rezultateve te marra dhe burimeve te perdorura. Shpesh eficensa kuptohet si aftesia per te arritur rezultate me cilesi sa me te larte, duke perdorur minimumin e mundshem te burimeve dhe te kohes.
Procedura:	Dokument ne te cilin pershkruhet menyra specifike e zhvillimit te nje aktiviteti ose procesi.
Formulari:	Dokumenti i plotesueshem dhe i arkivueshem, i cili permban regjistrimin perkates te nje aktiviteti apo procesi, te nje vleresimi ose te nje rezultati.
Burimet:	Jane mjete qe institucioni ose palet e interesuara vene ne dispozicion te zhvillimit te aktivitetit. Ato mund te jene:

- njerezore: personeli i stafit akademik, mbeshtetes, administrativ, etj;
- materialo-teknike: materialet qe blihen, librat, etj., impiantet, paisjet, tavolinat, bankat, dollapet, etj.;
- teknologjike: teknologjite mesimdheneze dhe kerkimore si dhe kompetencat e lidhura me to;
- infrastrukurore: klasat, sallat e studimit, sallat informatike, labororet, bibliotekat, sekretarite, sistemi elektrik, telefonik, informatik, etj.;
- financiare: parate disponibel ne buxhet, financime nga drejtime te ndryshme, subvencione, etj.

**DOKUMENTE PERMBLEDHES**

*PLANI KALENDAR I REALIZIMIT TE DOKUMENTACIONIT DHE TE IMPLEMENTIMIT  
TE PROCESIT PSI DHE TE PROJEKTEVE TE PROGRAMIT*

Nr.	KOHA EMERTIMI I AKTIVITETIT	VITI 2008				VITI 2009				VITI 2010				VITI 2011			
		TREMUIJORET															
		I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	III	IV
1	BAZA E PROGRAMIT			■	■												
2	PROCESI PSI				■	■	■										
3	PROJEKTI PR 1					■	■	■	■								
4	PROJEKTI PR 2						■	■	■	■	■	■					
5	PROJEKTI PR 3												■	■	■	■	■

Shenim: Dokumenti 1/5, Dokumenti 2/5, Dokumenti 3/5, Dokumenti 4/5 DHE Dokumenti 5/5 jane perfunduar ne fillim te periudhes perkatese (shenuar me nje vije te trashe)

*LIST-PAGESA E KONTRIBUESVE NE REALIZIMIN E PARAQITJES SE BAZES SE PROGRAMIT*

<b>N.r.</b>	<b>EMRI dhe MBIEMRI i KONTRIBUESIT</b>	<b>EMERTIMI i DETYRAVE TE KRYERA</b>	<b>PERIUDHA KOHORE</b>	<b>KOHA e PUNES</b>	<b>TARIFA ORARE</b>	<b>SHUMA e PAGESES</b>
<b>SHUMA TOTALE</b>						